



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21647 Prot.

Lezhë, më 18 . 12 . 2025

VENDIM

Nr. 114, Datë 15. 12. 2025

**Për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të qeverisjes vendore”, i ndryshuar; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi :**

1.Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027, si më poshtë;

Nr	Përshkrimi i Veprimatrisë	Afati	I ngarkuar për zbatim
1	Përgatitja dhe dërgimi në këshill për miratim i Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027.	Deri me datë 04.12.2025	Kryetari i Bashkisë Dr.Financës dhe Buxhetit.
2	Miratimi i Kalendarit të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2029.	Deri me datë 25.12.2025	Këshilli i Bashkisë
3	Përgatitja dhe paraqitja në këshill të Raportit të Vlerësimit dhe të Parashikimit Afatmesëm të të ardhurave për dy vitet e para të vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme. Në raport duhet të përfshihen; -metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave; -analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose ndryshimet e tyre. -analiza e risqeve dhe masave për përbalimin e tyre.	Deri me datë 31.01.2026	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Gjithë Drejtoritë e tjera
4	Përgatitja e paraqitja në këshill për miratim, i prioriteteve dhe projekteve për investime dhe koston e tyre. Qëllimet, objektivat dhe politikat sipas programeve, duke u adresuar edhe në respektimin e të ligjit “Për barazinë gjinore”.	Deri me datë 10.02.2026	Dr. Projekteve Strategjike Dr. Planifikimit Urban Gjithë Drejtoritë e tjera
5	Miratimi i Raportit të Vlerësimit dhe të Parashikimeve afatmesme të të ardhurave, prioriteteve të investimeve për të tre vitet e ardhshme 2027-2029.	Deri me datë 25.02.2026	Këshilli i Bashkisë

6	Përgatitja dhe paraqitja në Këshillin e Bashkisë të tavanëve përgatitore të shpenzimeve buxhetore të PBA-së 2027-2029 në nivel programi të miratuar nga GMS-ja.	Deri me datë 01.03.2026	Kryetari i Bashkisë Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
7	Miratimi i tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2027-2029 në nivel programi	Deri me datë 15.03.2026	Këshilli i Bashkisë
8	Hartimi i udhëzimit përkatës për përgatitjen e PBA-së 2027-2029, i cili duhet të përmbajë; -përcaktimin e programeve buxhetore dhe EMP përkatëse; -tavanet përgatitore të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet, të miratuar nga këshilli i bashkisë; -afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve (faza e parë)	Deri me datë 20.03.2026	Koordinatori i GMS-së Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
9	Miratimi i udhëzimit përkatës për përgatitjen e PBA-së 2027-2029 dhe të Buxhetit Vjetor 2027.	Deri me datë 20.03.2026	Kryetari i Bashkisë
10	Dërgimi i udhëzimit, manualit shpjegues, modelin e matricës, dhe kërkesave për plotësim nga EMP-ve (drejtoritë)	Deri me datë 22.03.2026	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
11	Plotësimi i matricave, fish/projekteve dhe paraqitja e kërkesave buxhetore sipas programeve nga EMP-it, dhe dorëzimi i tyre në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit me shkresë zyrtare, si dhe në rrugë elektronike. Hedhja e të dhënave në SMBV	Deri me datë 05.05.2026	Drejtuesit e EMP-it Sekretarët e EMP-it
12	Zhvillimi i konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, lidhur me nivelin e taksave, tarifave, dhe prioritetet e investimeve për tre vitet e ardhshme	Nga data 15-20.05.2026	Kryetari i Bashkisë G.M.S-ja
13	Përgatitja dhe paraqitja për vlerësim dhe miratim nga Grupi i Menaxhimit Strategjik i PBA-së 2027-2029 dhe kërkesave buxhetore të paraqitura nga drejtuesit e programeve (EMP).	Deri me datë 25.05.2026	Koordinatori i GMS-së Sekretari i GMS-së
14	Plotësimi i SMBV, dërgimi me shkrim dhe rrugë elektronike i projekt-dokumentit PBA 2027-2029 në Ministrinë e Financës.	Brenda datës 01.06.2026	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
15	Paraqitja për miratim në Këshillin e Bashkisë të projekt-dokumentit të PBA-së 2027-2029, të miratuar nga GMS-ja.	Deri me datë 01.06.2026	Kryetari i Bashkisë Dr.Financës dhe Buxhetit
16	Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-dokumentit të PBA-së 2027-2029, për fazën e parë nga ana e Këshillit të Bashkisë	Deri me datë 28.06.2026	Këshilli i Bashkisë
17	Publikimi i dokumentit të parë të PBA-së 2027-2029, pasi të jetë miratuar nga këshilli bashkiak.	Deri me datë 05.07.2026	Kryetari i Bashkisë Dr.Financës dhe Buxhetit
18	Përgatitja dhe paraqitja në këshillin e bashkisë për miratim të tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së për tre vitet e ardhshme në nivel programi për fazën e dytë.	Deri me datë 10.07.2026	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
19	Shqyrtimi dhe miratimi i tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së në nivel programi.	Deri me datë 20.07.2026	Këshilli i Bashkisë
20	Hartimi dhe miratimi i udhëzimit plotësues për përgatitjen e buxhetit, i cili përmban: -tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi; -afatet e përgatitjes së kërkesave buxhetore; -udhëzimi i miratuar nga kryetari i bashkisë dhe tavanet buxhetore, ju dërgohet gjithë drejtuesve EMP-it.	Deri me datë 25.07.2026	Kryetari i Bashkisë Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
21	Pas finalizimit të projekt-dokumentit të rishikuar, organizohen konsultime publike me komunitetin dhe grupet e interesit.	Nga data 01-10.09.2026	Kryetari i Bashkisë G.M.S-ja
22	Përgatitja dhe paraqitja për miratim në këshill të dokumentit të rishikuar të PBA-së 2027-2029.	Deri me datë 05.09.2026	Kryetari i Bashkisë Dr. Financës dhe Buxhetit
23	Miratimi nga këshilli bashkiak i dokumentit të rishikuar të PBA-së.	Deri me datë 15.09.2026	Këshilli i Bashkisë
24	Dërgimi në Ministrinë e Financës të dokumentit të PBA-së së rishikuar, miratuar nga këshilli, shoqëruar me një informacion	Deri me datë 15.09.2026	Kryetari i Bashkisë Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

	mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga M.Financës për fazën e parë.		
25	Pas marrjes së mendimeve përfundimtare nga Ministria e Financës të bëhet përgatitja e projektit të PBA-së 2027-2028 dhe projektbuxhetit për vitin 2027. Miratimi nga GMS-ja.	Deri me datë 25.11.2026	Drejtoria e Financës Drejtuesit e EMP-it dhe GMS-ja
26	Projektdokumenti i PBA-së 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027 të paraqitet për miratim në këshillin e bashkisë	Brenda datës 30.11.2026	Kryetari i Bashkisë Dr.Financës dhe Buxhetit
27	Zhvillimi i dëgjesave publike me banorët, grupet e interesit, specialistë të fushave, institucione të interesuara dhe OJF.	Nga data 1-20.12.2026	Këshilli i Bashkisë
28	Shqyrtimi dhe miratimi i PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027.	Deri me datë 25.12.2026	Këshilli i Bashkisë
29	Publikimi i dokumentit të plotë të PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027.	Deri me datë 31.12.2026	Kryetari i Bashkisë Dr. Financës dhe Buxhetit

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli i Bashkisë Lezhë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI  
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1249/4 Prot.

Lezhë, më 24.12.2025

Nr. 21647/ Prot  
Dt. 25-12-25  
K.B

Lënda: Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

Për Dijeni: **KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar ; ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ; Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të të përgaditjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të qeverisjes vendore, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.114, datë 15.12.2025 të këshillit të bashkisë Lezhë " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027."



**PREFEKTI**

Taulant MALSHI

